REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

VENDIM

Nr. 3, datë 16.01.2023

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {…} PËR VITIN 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve" dhe nr. 264, datë 21.11.2019, "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", pasi shqyrtoi "Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {…}, për vitin 2021", i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {…} për vitin 2021", duke e vlerësuar atë si më poshtë:
   - **A.** Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";
   - **B.** Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";
   - **C.** Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";
   - **D.** Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shumë mirë".
     Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shumë mirë".
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike "*Iura novit curia" – "Gjykata e njeh ligjin".* Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes***

Gjyqtari i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar të rrethanave procedurale dhe të fakteve të çështjes, përshkrim i cili zhvillohet duke iu referuar provave të administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, por duke i analizuar ato në mënyrë të pavarur. Kështu, gjyqtari kujdeset që përshkrimin e rrethanave të çështjes ta realizojë duke integruar provat mbi të cilat fakti ekstraktohet. Në këtë mënyrë, faktet evidentohen lehtësisht në vendim.

Pavarësisht, nëse shkaqet e ankimit konsistojnë ose jo në përcaktimin e saktë të rrethanave të faktit, gjyqtari i përshkruan dhe analizon ato në çdo rast, duke bërë të qartë faktin në tërësinë e tij, për të vijuar më pas me analizën ligjore bazuar mbi shkaqet e ankimit. Vetëm në një rast gjyqtari nuk ka trajtuar faktet e çështjes, por është ndalur në rrethanat procedurale të saj, pasi gjykata e shkallës së parë kishte disponuar për pushimin e gjykimit. Në këtë mënyrë, gjyqtari është ndalur në trajtimin kronologjik të ecurisë procedurale të çështjes gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke vlerësuar më pas nëse vendimi i pushimit është marrë në përputhje me ligjin procedural.[1]

Gjyqtari kujdeset të trajtojë faktet e çështjes *(penale apo civile)* në mënyrë të pavarur nga sa kanë pretenduar palët dhe sa ka pranuar gjykata e shkallës së parë në vendimin objekt ankimi. Për këtë qëllim, ai zhvillon një analizë të plotë të provave të administruara, prej nga evidentohen lehtësisht faktet të cilat i shërbejnë arsyetimit ligjor në vendim.

Në pikëpamje të strukturës, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim penal apo gjykim civil themeli*), faktet e çështjes parashtrohen gjithmonë në fillim të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit, menjëherë pas paraqitjes së konkluzionit lidhur me bazueshmërinë ose jo të vendimit të ankimuar. Parashtrimi i tyre bëhet në mënyrë të qartë dhe në bazë të rendit kronologjik. Gjithashtu, evidentohet se faktet gjenden edhe tek pjesa e vlerësimit ligjor mbi çështjen, ku analizohet marrëdhënia provë-fakt dhe fakt-ligj, analizë e cila zhvillohet si në rastet kur vlerësimi i tyre nga gjykata e shkallës së parë është gjetur i drejtë, ashtu edhe në rastet kur gjykata e apelit ka vlerësuar ndryshe elementë të caktuar të faktit. Në këtë mënyrë, gjyqtari i jep qartësi dhe plotësi arsyetimit të vendimit.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes***

Referuar të gjitha vendimeve të analizuara, rezulton se natyra juridike e çështjes është e qartë. Megjithëse gjyqtari nuk ndalet në trajtimin e mëvetësishëm të saj, natyra juridike e çështjes, zbulohet rast pas rasti duke iu referuar mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe ligjit të aplikuar për zgjidhjen e saj. Gjithashtu, ajo citohet në pjesën hyrëse të vendimit përkatës apo në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese, ku gjyqtari parashtron konkluzionin mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë *(duke specifikuar civil apo penal).*

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm***

Identifikimi i saktë i natyrës së çështjes lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e saj. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore, të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori *(i)* vendime civile dhe *(ii)* vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e çështjes, konstatohet sa më poshtë vijon :

Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, nisur nga rrethanat procedurale të gjykimit apo natyrës së gjykimit dhe vendimmarrjes, gjyqtari ka identifikuar dispozitat si më poshtë vijon.

---

[1] *Vendimi nr. 471/1624, datë 28.09.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.*

Në vendimet për çështjet penale:

(i) Nenin 152 të K. Pr. Penale në lidhje me çmuarjen e provave[2];

(ii) Nenet 403 e vijues të K. Pr. Penale në lidhje me procedimin sipas gjykimit të shkurtuar[3];

(iii) Nenin 425 të K. Pr. Penale në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykimin në Gjykatën e Apelit[4];

(iv) Nenin 428/a,b të K. Pr. Penale në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së apelit[5];

(v) Nenin 447 të K. Pr. Penale në lidhje me rigjykimin e çështjes pas prishjes së vendimit[6];

(vi) Nenet 488-504 të K. Pr. Penale në lidhje me ekstradimin.[7]

Në vendimet për çështjet civile:

(i) Nenin 14 të K. Pr. Civile në lidhje me procesin e rregullt ligjor [8];

(ii) Nenin 16 të K. Pr. Civile në lidhje me të drejtën e aplikuar nga gjykata dhe cilësimin e fakteve për efekt të zgjidhjes së mosmarrëveshjes[9];

(iii) Nenet 201 dhe 299 të K. Pr. Civile në lidhje me të drejtën për heqjen dorë nga gjykimi i padisë dhe pasojat e saj[10];

(iv) Nenin 213 të K. Pr. Civile në lidhje me lejimin e provave në gjykim [11];

(v) Nenin 309 të K. Pr. Civile në lidhje me mënyrën e çmimit të provave të marra gjatë gjykimit [12];

(vi) Nenet 369-374 të K. Pr. Civile në lidhje me pjesëtimin gjyqësor [13];

(vii) Nenin 465 të K. Pr. Civile në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit[14];

(viii) Nenin 466/a dhe 467 të K. Pr. Civile në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së apelit [15];

(ix) Nenin 510/d të K. Pr. Civile në lidhje me titujt ekzekutivë[16];

(x) Nenin 547 të K. Pr. Civile në lidhje me pavlefshmërinë e disponimit pas vënies së sekuestros[17];

(xi) Nenin 578 të K. Pr. Civile në lidhje me ekzekutimin mbi një send të paluajtshëm në bashkëpronësi[18];

(xii) Nenin 606 dhe 610 të K. Pr. Civile në lidhje me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.[19]

---

[2] Vendimi nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[3] Vendimi nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[4] Vendimi nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[5] Vendimi nr. 121, datë 20.04.2021, nr. 1720/279, datë 07.10.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[6] Vendimi 121, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[7] Vendimi 121, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[8] Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021, nr. 129/644, datë 08.04.2021, nr. 152/458, datë 16.03.2021 dhe nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[9] Vendimi nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[10] Vendimi nr. 471/1624, datë 28.09.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[11] Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021, nr. 129/644, datë 08.04.2021, nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[12] Po aty

[13] Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021 dhe nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[14] Vendimi nr. 129/644, datë 08.04.2021, nr. 152/458, datë 16.03.2021 dhe nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[15] Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021, nr. 471/1624, datë 28.09.2021, nr. 129/664 datë 08.04.2021, nr. 152/458, datë 16.03.2021 dhe nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[16] Vendimi nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[17] Vendimi nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

[18] Po aty

[19] Vendimi nr. 129/644, datë 08.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, nisur nga objekti dhe shkaku i kërkimit në çështjet civile, si dhe kërkimi i prokurorit në çështjet penale, gjyqtari ka identifikuar dispozitat si më poshtë vijon.

Në vendimet për çështjet penale:

(i) Nenin 39/2 të Kushtetutës dhe nenin 11 të K. Penal në lidhje me ekstradimin [20];

(ii) Nenin 17/1 të Kushtetutës në kuadër të parimit të proporcionalitetit në caktimin e dënimit penal, si dhe nenet 47 e vijues të K. Penal në lidhje me caktimin e dënimit[21];

(iii) Nenin 59 të K. Penal dhe nenin 104 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim[22];

(iv) Nenin 100/1 të K. Penal *"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur",* nenin 130/a të K. Penal *"Dhuna në familje",* nenin 321 të K. Penal *"Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës"* në kuadër të kualifikimit të faktit penal[23]

Në vendimet për çështjet civile:

(i) Nenet 20-23 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 *"Për privatizimin e banesave shtetërore",* lidhur me kushtet e nevojshme në kuadër të privatizimit [24];

(ii) Nenin 207 të K. Civil në lidhje me pjesëtimin e sendit të përbashkët [25];

(iii) Nenin 164 të K. Civil në lidhje me fitimin e pronësisë me kontratë, si dhe nenin 706 të K. Civil në lidhje me kontratën e shitjes së sendit të ardhshëm [26];

(iv) Nenin 141 të K. Punës në lidhje me zgjidhjen e kontratës me kohëzgjatje të pacaktuar, si dhe nenin 153 të K. Punës në lidhje me konceptin *"shkaqe të justifikuara"* në kuadër të zgjidhjes së kontratës[27];

(v) Nenin 9 dhe 19 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 *"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"* në lidhje me natyrën dhe organizimin e këtij institucioni, si dhe nenin 13 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 *"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"* në lidhje me kompetencat e Ministrit të Drejtësisë[28].

Gjithashtu, në një rast gjyqtari ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe ligjin nr. 8322/1998 me të cilin është ratifikuar Konventa e Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe dy protokollet shtesë të saj, si dhe ligjin nr. 9871/2008 me të cilin është ratifikuar Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin e 13 Dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmën Juridike për Çështjet Penale e 20 Prillit 1959.[29]

-***Në lidhje me konfliktin e normave materiale apo procedurale:***

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

---

[20] Vendimi nr. 121, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[21] Vendimi nr. 279/1720, datë 07.10.2021 dhe nr. 64/311 datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[22] Vendimi nr. 64/311 datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[23] Vendimi nr. 279/1720, datë 07.10.2021 dhe nr. 64/311 datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[24] Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[25] Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[26] Vendimi nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[27] Vendimi nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[28] Po aty.
[29] Vendimi nr. 121, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çeshtjes.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material dhe procedural të zbatueshëm:***

Interpretimi i normës juridike përgjithësisht realizohet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin dhe funksionin e saj apo duke evidentuar kushtet dhe kriteret e sanksionuara prej saj, për t'u aplikuar mbi faktin konkret të provuar në gjykim apo mbi situatën procedurale të shtruar për zgjidhje. Konkretisht, referuar vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se:

(i) Në funksion të gjykimit në fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë, gjyqtari trajton natyrën e gjykimit për pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi, fazat në të cilat kalon ky lloj gjykimi referuar neneve 369-374 të K. Pr. Civile, si dhe fokusin e gjykatës gjatë fazës së parë të gjykimit.[30]

(ii) Në funksion të vlerësimit të kontratës së privatizimit si titull pronësie, gjyqtari analizon nenin 20 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 *"Për privatizimin e banesave shtetërore",* duke specifikuar dy kushte të cilët duhet të verifikohen në mënyrë kumulative: *(i)* përbërja familjare në datën 1 dhjetor*; (ii)* gjendja e strehimit në këtë datë. [31]

(iii) Në funksion të vlerësimit të ankimit ndaj veprimeve përmbarimore, gjyqtari zhvillon analizën juridike të nenit 610 të K. Pr. Civile, duke u ndalur në kuptimin, objektin dhe shkakun e ankimeve të kësaj natyre.[32]

(iv) Në funksion të gjykimit të padive me objekt veçimin e pjesës takuese, gjyqtari zhvillon analizën juridike të nenit 578 të K. Pr. Civile, në lidhje me ekzekutimin mbi një send të paluajtshëm në bashkëpronësi. Në këtë analizë, gjyqtari fokusohet në natyrën e këtij gjykimi, si dhe elementët që duhet të verifikohen në kuadër të tij.[33]

---

[30] *Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.*
[31] *Vendimi nr. 368, datë 22.06.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.*
[32] *Vendimi nr. 129/664, datë 08.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.*
[33] *Vendimi nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.*

(v) Në funksion të vlerësimit të mënyrës së zgjidhjes së kontratës së punës, gjyqtari ndalet në analizën e ligjit referuar doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore në këtë drejtim. Në këtë kuadër, gjyqtari evidenton dy mënyra të përfundimit të marrëdhënies së punës me afat të pacaktuar, atë normale dhe atë të jashtëzakonshme, duke trajtuar edhe kuptimin përkatës për secilën prej tyre. Gjithashtu, gjyqtari merr në analizë të detajuar konceptin e *"shkakut të justifikuar"* në zgjidhjen e marrëdhënies së punës, duke u ndalur në natyrën dhe pasojat e tij.[34]

(vi) Në funksion të gjykimit të kërkesës për ekstradim, gjyqtari analizon institutin e ekstradimit, duke u ndalur në kuptimin dhe procedurën e realizimit të tij. Në lidhje me kuptimin, gjyqtari ndalet në trajtimin e ekstradimit si një ndër format e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar me autoritetet e huaja në fushën e marrëdhënieve juridiksionale, i cili referuar Kushtetutës mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe vetëm me vendim gjyqësor. Ndërkohë, në lidhje me procedurën e realizimit të tij, gjyqtari ndalet në evidentimin e dispozitave ligjore të zbatueshme.[35]

(vii) Në funksion të kualifikimit të faktit penal, zhvillon analizën juridike të veprës penale *"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur",* parashikuar nga neni 100/1 i K. Penal, veprës penale *"Dhuna në familje",* parashikuar nga neni 130/a i K. Penal, si dhe veprës penale *"Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës",* parashikuar nga neni 321/2 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive për secilën.[36]

(viii) Në funksion të caktimit të dënimit, gjyqtari zhvillon analizën juridike të dënimit penal, duke trajtuar qëllimin e tij, si dhe rregullat që duhet të mbahen parasysh në caktimin e tij, duke mbajtur në konsideratë veçanërisht parimin e individualizimit të dënimit dhe të proporcionalitetit, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës.[37]

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante***

Në disa prej vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe referuar jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në lidhje me:

(i) Rëndësinë e regjistrimit të veprimit juridik për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme në regjistrat përkatës, duke iu referuar vendimit unifikues nr. 1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.[38]

(ii) Institutin e zgjidhjes së kontratës së punës, referuar vendimit unifikues nr. 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.[39]

(iii) Konceptin e *"shkakut të justifikuar"* në zgjidhjen e marrëdhënies së punës, referuar vendimit unifikues 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.[40]

(iv) Dënimin penal referuar vendimit nr. 19, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese .[41]

(v) Parimin *"ne bis in idem"* referuar vendimit nr. 00-2019-181(5) datë 22.11.2019 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.[42]

---

[34] Vendimi nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[35] Vendimi nr. 121, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[36] Vendimi nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[37] Vendimi nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[38] Vendimi nr. 152/458, datë 16.03.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[39] Vendimi nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[40] Vendimi nr. 421/1282, datë 08.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.
[41] Vendimi nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës
[42] Vendimi nr. 121, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.

(vi) Qëllimin e aplikimit të nenit 59 të K. Penal referuar vendimit nr. 50, datë 29.03.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. [43]

- ***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:***

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtari përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet si duke i përmendur ato shprehimisht, ashtu edhe nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur. Në mënyrë më specifike, rezulton si më poshtë:

(i) Në vendimet për çështjet civile, gjyqtari citon dhe aplikon *parimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm*, në kuadër të parimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor referuar nenit 14 të K. Pr. Civile;

(ii) Në vendimin nr. 121, datë 20.04.2021, gjyqtari referon parimin *ne bis in idem,* për efekt të vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesës për ekstradim;

(iii) Në vendimet nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021, në funksion të caktimit të dënimit, gjyqtari citon *parimin e individualizimit të dënimit;*

(iv) Në vendimin nr. 311/64, datë 25.02.2021, gjyqtari citon *parimin e proporcionalitetit në caktimin e dënimit*, duke sqaruar se dënimi penal në aspektin kushtetues duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën, referuar nenit 17/1 të Kushtetutës.

Gjithashtu konstatohet *zbatimi i parimit të procesit të rregullt ligjor*, duke përfshirë aspektet procedurale të kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor, *zbatimi i parimit të ligjshmërisë* etj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor. Në mbështetje të analizës juridike të çështjes, gjyqtari referon edhe në qëndrime të doktrinës lidhur me koncepte të caktuara juridike, duke i dhënë vlerë të shtuar dhe duke qartësuar kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Këtij të fundit në të gjitha vendimet e analizuara i bëhet një zbërthim abstrakt i çdo elementi, bazuar në qëllimin e normës juridike, mbi të cilin gjyqtari bazohet për t' i dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

[43] *Vendimi nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjuha e përdorur nga gjyqtari në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Gjyqtari kujdeset të përdorë terminologji korrekte dhe teknike, aty ku është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht *p.sh* në aktet e ekspertimit të realizuar nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe tregohet kujdes në shmangien e përdorimit të fjalëve fyese apo denigruese.

Karakteristikë e mënyrës së të shkruarit të vendimit gjyqësor është pasqyrimi i qartë dhe analitik i fakteve të çështjes dhe arsyetimit ligjor të çështjes si dhe ndërthurja e fakteve me interpretimin e ligjit të zbatueshëm. Mënyra e shprehjes së mendimit juridik nga ana e gjyqtarit zhvillohet nëpërmjet një balancimi të të shkruarit në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë me ndërthurjen e argumenteve ligjore të cilat zhvillohen në mënyrë logjike dhe të lidhura me njëra tjetrën.

Sa i takon aspektit gramatikor, gjyqtari tregon kujdes dhe vëmendje për mënyrën e ndërtimit të fjalive dhe paragrafëve, duke respektuar rregullat e gjuhës shqipe. Evidentohet se edhe pse gjyqtari ndërton fjali të gjata, kjo bëhet me qëllim që të mos ndërpresë kuptimin e mendimit. Ndërtimi i paragrafëve karakterizohet nga lidhja e tyre me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit.

Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, reflekton qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë mënyrë, vendimet janë të qarta dhe të kuptueshme, jo vetëm për njohësit e ligjit, por edhe për një lexues me njohuri mesatare.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Pjesët e vendimit përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie ose konkluzionin mbi të cilin shtjellohen argumentet mbështetëse. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 15 pikë.*

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimeve. Konkretisht, vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe shkaqet e ankimit, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur.[44]

Pjesa përshkuese - arsyetuese është e ndarë në disa nën pjesë. Kryesisht pjesa përshkruese - arsyetuese e vendimit ndjek këtë organizim: konkluzioni i Gjykatës së Apelit lidhur bazueshmërinë ose jo të vendimit gjyqësor objekt ankimi; faktet e çështjes të ndërthurura me provat mbi të cilat mbështeten ato; vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe argumentat bazë të tij; ankimi i paraqitur; vlerësimi i shkaqeve të ankimit në tërësi dhe më pas analiza në mënyrë të detajuar për secilin prej tyre, duke referuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm, si dhe duke e aplikuar atë mbi faktet e çështjes të provuara në gjykim, për të përfunduar argumentin me një konkluzion mbi bazueshmërinë ose jo të çdo shkaku ankimi. Në përfundim të pjesës përshkruese arsyetuese, paraqitet konkluzioni tërësor i gjykatës lidhur me bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ankimit, si dhe vlerësimin mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë objekt ankimimi.[45]

---

[44] *Vetëm në një rast, nisur nga kronologjia procedurale e shqyrtimit të çështjes, rezulton të mos jenë pasqyruar shkaqet e ankimit. Konkretisht, në vendimin nr. 121, datë 20.04.2021, rezulton që të jetë pasqyruar disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, i Gjykatës së Apelit dhe më pas i Gjykatës së Lartë, në bazë të së cilës çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit, duke lënë edhe detyrat përkatëse.*

[45] *Vetëm në një rast, nisur nga kronologjia procedurale e shqyrtimit të çështjes, pjesa përshkruese – arsyetuese ndjek tjetër organizim. Konkretisht, në vendimin nr. 121, datë 20.04.2021, duke qenë se çështja në themel të tij rezulton të jetë konsistuar për shkak të prishjes dhe kthimit për rigjykim nga Gjykata e Larta, ndjek organizimin si vijon: konkluzioni i Gjykatës së Apelit lidhur bazueshmërinë ose jo të vendimit gjyqësor objekt ankimi; faktet e*

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K. Pr. Civile *(në vendimet për çështjet civile)* apo nenit 428 të K. Pr. Penale *(në vendimet për çështjet penale)*, e drejta e palëve për të paraqitur rekurs ndaj vendimit, si dhe data e shpalljes së vendimit.

Referuar analizës së mësipërme, konstatohet se gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, zbaton rregullat e shkrimit ligjor, kryesisht sipas metodës *CRAC*[46], duke paraqitur në fillim konkluzionin mbi bazueshmërinë e vendimit objekt ankimi, dhe më pas duke analizuar rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, argumentimin ligjor lidhur me shkaqet e ankimit, për të përfunduar me konkluzionin tërësor mbi bazueshmërinë e tyre. Gjithashtu, konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural përkatës. Konkretisht, vendimet civile përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 310 të K. Pr. Civile dhe nenin 466 të K. Pr. Civile, ndërsa vendimet penale përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, duke ndjekur rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor. Gjyqtari përdor një metodologji të unifikuar në strukturimin e vendimit edhe pse në aspektin vizual jo gjithmonë është e dallueshme, metodologji e cila i jep rrjedhë logjike analizës dhe argumentimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNj-ja është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar[47].

çështjes të ndërthurura me provat mbi të cilat mbështeten ato; vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe argumentet bazë të tij; vendimi i Gjykatës së Apelit; vendimi i Gjykatës së Lartë, argumentet bazë të tij dhe detyrat e lëna për gjykatën e rigjykimit; analiza e Gjykatës së Apelit për detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, si dhe verifikimi i kritereve penguese të parashikuara në neni 491 të K. Pr. Penale; konkluzioni i Gjykatës së Apelit.

[46] *CRAC (Conclusion, Rule, Application, Conclusion).*

[47] *Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se arsyetimi është i plotë dhe i qartë, me fokus në çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, referuar shkaqeve të ankimit, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila fokusohet në faktet thelbësore të çështjes, shoqëruar me provat në funksion të vërtetimit të tyre. Gjithashtu, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e marrëdhënies shkak-pasojë. Kjo e fundit, nxjerr në pah thelbin e mosmarrëveshjes dhe në mënyrë logjike zhvillon lidhjen me institutet e së drejtës të aplikuara në zgjidhjen e çështjes konkrete *(civile apo penale)*, por gjithnjë duke iu përmbajtur shkaqeve të ankimit.

Në vendimet civile të analizuara, gjyqtari tregon kujdes të veçantë në evidentimin e marrëdhënies juridike në themel të konfliktit, dispozitave ligjore që disiplinojnë atë në mënyrë abstrakte dhe më pas zbatimin e tyre në situatën konkrete. Gjyqtari kujdeset që analiza të realizohet mbi bazën e zhvillimit logjik të koncepteve ligjore, duke integruar ligjin e zbatueshëm dhe analizën e tij, në faktet e provuara, për të konkluduar mbi zgjidhjen përkatëse. Në këtë mënyrë, argumentet ndjekin një linjë arsyetimi, e cila zhvillohet në mënyrë dinamike mbi çdo fakt apo çështje të marrë në analizë, duke mbështetur në mënyrë logjike konkluzionin e arritur.

Në vendimet penale të analizuara, analiza dhe arsyetimi shtjellohen në mënyrë logjike. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit ligjor të gjykatës ku ai integrohet me analizën ligjore, e bën atë një analizë të plotë, të gjithanshme dhe të kuptueshme për lexuesin. Në vendimet e themelit, gjyqtari i kushton rëndësi të veçantë analizës së integruar të provave në raport me katër elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, duke konkluduar më pas për bazueshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me kryerjen dhe kualifikimin e faktit penal. Gjithashtu, gjyqtari i kushton rëndësi individualizimit të dënimit, duke marrë në analizë rrethanat konkrete të çështjes në raport me parashikimet e nenit 47 e vijues të K. Penal që disiplinon caktimin e dënimit, si dhe proporcionalitetin e ligjshmërinë e tij referuar nenit 17/1 të Kushtetutës. Në këtë mënyrë, gjyqtari konkludon edhe mbi bazueshmërinë e llojit dhe masës së dënimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë.[48] Ndërkohë, në vendimin mbi kërkesën për ekstradim, duke qënë se çështja ishte dërguar për rigjykim nga Gjykata e Lartë në Gjykatën e Apelit, gjyqtari kujdeset fillimisht të marrë në analizë detyrat e caktuara nga Gjykata e Lartë dhe më pas fokusohet në çështjet të cilat verifikohen kryesisht, përkatësisht ato të parashikuara si kriteret penguese referuar nenit 491 të K. Pr. Penale.[49]

Në tërësi, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga palët, si dhe çështjeve me karakter procedural të vlerësuara të nevojshme për tu analizuar nga ana e gjykatës.

KONKLUZIONI

---

[48] *Vendimi nr. 1720/279, datë 07.10.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës*

[49] *Vendimi nr. 121 datë 20.04.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës*

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari shfaq aftësi shumë të lartë në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Gjyqtari analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjesh, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtari e zhvillon argumentimin e tij duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për ti dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur të standardin e procesit të rregullt ligjor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit **KRITERI** **AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT**	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezultojnë 158 çështje për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, nga të cilat 32 çështje kanë përfunduar tej këtij afati. Sipas kategorive, rezultojnë të gjykuara tej afatit ligjor, çështjet si më poshtë:

(i) **2 çështje** nga kategoria "*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*" me objekt "*pavlefshmëri e titullit ekzekutiv*", të cilat kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (60 ditë) të parashikuar në nenin 609 të K.Pr.Civile, duke e tejkaluar këtë afat me 19 dhe 40 ditë. Referuar shpjegimeve të paraqitura nga gjyqtari në lidhje me këto çështje, rezulton se çështja me numër rendor 3 ka pasur disa kërkime në përmbajtje të saj, për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat ligjor. Ndërkohë, çështja me numër rendor 39 i ka kaluar gjyqtarit për gjykim pas rishortimit, me shortin e datës 30.09.2021 dhe është përfunduar më datë 19.10.2021, pra brenda afatit ligjor. Duke zbritur kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes, deri në

momentin e rishortimit, rezulton se çështja është përfunduar brenda 19 ditësh. *Sa më sipër**, një çështje** do të konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor.*

(ii) **4 çështje** nga kategoria "*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*" dhe **1 çështje** nga kategoria "*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*" me objekt "*kundërshtim i veprimeve përmbarimore*", të cilat kanë përfunduar tej afatit ligjor të parashikuar nga neni 610 i K. Pr. Civile, përkatësisht 30 ditë kur çështja shqyrtohet në dhomë këshillimi dhe 45 ditë kur çështja shqyrtohet në seancë. Në mungesë të të dhënave në tabelat statistikore për mënyrën e shqyrtimit të çështjeve (*në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore*), përllogaritja bëhet duke konsideruar afatin 45 ditor të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore. Mbi këtë bazë, rezulton se *(i)* një prej çështjeve *(përkatësisht ajo me nr. rendor 13, tabela 1)* është gjykuar brenda afatit 45 ditë; *(ii) çështja me nr. rendor 35* është regjistruar dhe shortuar në datë 28.07.2021 dhe ka përfunduar në datë 28.09.2021, për 2 muaj. Nëse nga kohëzgjatja e saj zbresim 35 ditë të cilat përbëjnë lejen vjetore të gjyqtarëve, rezulton se gjykimi ka përfunduar për 25 ditë, brenda afatit ligjor 45 ditor. *Sa më sipër, këto **dy çështje** konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor.*

Ndërkohë, çështjet e tjera janë gjykuar duke tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit, me një interval të përgjithshëm kohor prej 9 deri 160 ditë.

(iii) **2 çështje** nga kategoria "*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*" me objekt *"Dhënie vendim me ekzekutim të përkohshëm"* dhe *"Ndërhyrje dytësore"*, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit ligjor 30 ditë të parashikuar nga neni 470, pika 3 i K. Pr. Civile[50]. Çështja me nr. rendor 29, rezulton se është regjistruar në gjykatë në datë 10.09.2021, por është shortuar në datë 30.09.2021 dhe ka përfunduar në datë 11.11.2021, pra për një kohëzgjatje prej 2 muaj nëse i referohemi datës së regjistrimit dhe 1 muaj e 11 ditë nëse i referohemi datës së shortimit të saj. Të dy çështjet kanë tejkaluar afatin ligjor me përkatësisht 18 dhe 11 ditë (*duke konsideruar tek kjo e fundit datën e shortimit të çështjes*).

(iv) **1 çështje** nga kategoria "*familjare me palë kundërshtare*", me objekt "*lëshim urdhër mbrojtje*", e cila ka përfunduar jashtë afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga neni 21, pika 2 i ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar. Kjo çështje rezulton të jetë gjykuar duke tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit me 45 ditë. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit zbritet leja vjetore në muajin gusht prej 35 ditësh, rezulton se afati ligjor është tejkaluar me 10 ditë[51].

(v) **12 çështje** nga kategoria "*kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak*", me objekt "*ankim ndaj vendimit të mos fillimit të procedimit penal*", të cilat kanë përfunduar tej afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 291, pika 5[52] i K. Pr. Penale. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 89, 90, 91, 92 dhe 93 janë regjistruar përkatësisht në datat 23.07.2021, 28.07.2021, 23.07.2022, 23.07.2021 dhe 23.07.2021, ndërkohë vendimi është dhënë përkatësisht më datë 22.09.2021, 22.09.2021, 22.09.2021, 22.09.2021 dhe 23.09.2021. Rrjedhimisht, duke zbritur periudhën e lejes vjetore që zhvillohet në muajin gusht (35 ditë), këto çështje do të rezultonin të gjykuara brenda afatit ligjor. Ndërkohë, referuar shpjegimeve të gjyqtarit në formularin e integruar të vlerësimit, çështjet me numër rendor 95, 96 dhe 97, i kanë kaluar gjyqtarit për gjykim pas rishortimit, përkatësisht me shortin e datës 29.09.2021, 29.09.2021, 06.10.2021 dhe janë përfunduar përkatësisht më datë 18.10.2021, 21.10.2021 dhe 26.10.2021, pra brenda afatit ligjor.

---

[50] *Në nenin 470, pika 3 të K.Pr.C parashikohet se :" 3. Ankimet ose rekurset e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë.".*

[51] *Çështja me nr. rendor 23, tabela nr. 2, e cila është regjistruar në gjykatë dhe shortuar në datë 30.07.2021 dhe ka përfunduar në datë 30.09.2021.*

[52] *Neni 291, pika 5 i K.Pr.P parashikon se :" 5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve.".*

Ndërkohë, çështjet e tjera janë gjykuar duke tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit, me një interval të përgjithshëm kohor prej 10 deri 17 ditë. Sa më sipër, ***8 (tetë) çështjet*** të cilat rezultojnë të përfunduara brenda 30 ditësh, duke konsideruar zbritjen e periudhës së lejes vjetore ose rishortimin e tyre, ***konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor***.

(vi) **10 çështje** nga kategoria "*penale seancë paraprake*", me objekt "*ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes*", të cilat kanë përfunduar tej afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga neni 329, pika 7[53] i K. Pr. Penale. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështja me numër rendor 4, ka përfunduar për 20 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me 5 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari. Ndërkohë, çështjet e tjera janë gjykuar duke tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit, me një interval të përgjithshëm kohor prej 7 deri 111 ditë. Në këto kushte, do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 9 prej çështjeve me objekt "*ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes*", përveç ***një çështje*** e cila, siç u analizuar më sipër, ka tejkaluar afatin ligjor me vetëm 5 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm.

(vii) **1 çështje** nga kategoria "*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit*", me objekt "*rivendosje në afat*", e cila ka përfunduar tej afatit ligjor 10 ditor të parashikuar nga neni 147 pika 4[54] i K. Pr. Penale. Kjo çështje rezulton të jetë gjykuar duke tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit me 4 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari. ***Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie nuk do të konsiderohet asnjë çështje e shqyrtuar tej afatit ligjor.***

Në tërësi, nga 158 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (*duke zbritur çështjet e analizuara më sipër të cilat konsiderohen të përfunduara në afat*), rezulton që gjyqtari ka përfunduar jashtë afatit ligjor 20 çështje ose 12 % të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë[55].

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka argumentuar shkaqet që kanë ndikuar në numrin e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, duke u ndalur fillimisht në një analizë të përgjithshme, e më pas në analizën e disa prej çështjeve në mënyrë të veçantë. Referuar shkaqeve të përgjithshme, gjyqtari ka vendosur theksin: (i) së pari, tek fakti se në Gjykatën e Apelit Durrës nuk ka pasur dhe nuk ka ndarje në dhoma penale dhe civile dhe, në këtë kuptim, ai ka gjykuar çështje të natyrave të ndryshme, të cilat jo vetëm për nga natyra, por edhe nga kompleksiteti, rritin shkallën e vështirësisë së gjykimit; (ii) së dyti, tek fakti se për shkak të vendimmarrjes së KPK, është bërë rishortimi i dosjeve të dy gjyqtarve, duke rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën; (iii) së treti, tek numri i ulët i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Referuar, shkaqeve në çështje të veçanta, gjyqtari ka identifikuar çështjet të cilat i kanë kaluar pas rishortimit si rezultat i vendimmarrjes së KPK-së apo heqjes dorë të gjyqtarëve të tjerë, çështjet në të cilat duke zbritur pushimet gjatë muajit gusht do të rezultonin të gjykuara në afat, si dhe çështjet të cilat kanë pasur në përbërje të tyre disa objekte gjykimesh *(me dhe pa afat ligjor)*[56].

---

[53] *Neni 329, pika 7 i K.Pr.P parashikon se :" 7. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve.".*

[54] *Neni 147, pika 4 i K.Pr.P parashikon se :" 4. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.".*

[55] *Në metodologjinë e pikëzimit, marzhi i përqindjes së çështjeve të përfunduara tej afati ligjor 11-20 % pikëzohet me 12 pikë.*

[56] *Këto pretendime të gjyqtarit janë analizuar gjatë parashtrimit të çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor.*

KONKLUZIONI

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret:

i) ngarkesa e lartë e gjyqtarit si relator dhe anëtar (*në total ka gjykuar 395 çështje si relator dhe 761 çështje si anëtar*);

ii) ngarkesa e shtuar e gjyqtarit për shkak të caktimit të tij për të gjykuar në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo në të cilin ai ushtron kontrollin, në total për 21 çështje;

iii) vetëvlerësimi i gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;

iv) numri i lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtari ka qenë relator pasi rezulton se ka përfunduar 158 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë 40 % të çështjeve të shqyrtuara prej tij në vitin 2021;

v) tejkalimin e pragut të përqindjes që çon në pikëzim maksimal të këtij treguesi me vetëm 2 %.

Sa më sipër, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se sa rezulton nga të dhënat statistikore, dhe konkretisht me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Referuar sa më sipër në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 12 %, por ndërkohë gjyqtari ka përfunduar një numër tepër të lartë çështjesh si relator dhe 40 % e tyre janë çështje me afat ligjor.*

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

(i) **6 çështje** tek tabela nr. 1 e kategorisë "*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*", dhe konkretisht çështjet me nr. rendor 2, 10, 17, 33, 34 dhe 50, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim;

(ii) **1 çështje** tek tabela nr. 2, e kategorisë "*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*", dhe konkretisht çështja me nr. rendor 7, e cila ka përfunduar jashtë afatit 4 (katër) mujor të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim;

(iii) **4 çështje** tek tabela nr. 8, e kategorisë "*penale krime*", dhe konkretisht çështjet me nr. rendor 2, 28, 43 dhe 48, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 muaj për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim/9 muaj për krime që dënohen në maksimum jo më pak se 10 vjet burgim, të parashikuar në pikën 5/g të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Nga këto çështje ajo me ***numër rendor 43***, rezulton të jetë nxjerrë për gjykim në datë 06.05.2021 dhe ka përfunduar në datë 02.12.2021, për një kohëzgjatje prej 6 muaj 26 ditë. Por kjo çështje rezulton se ka pasur për objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a, pg 2 të Kodit Penal për të cilën parashikohet dënimi me

burgim nga 10 deri në 20 vjet, për pasojë standardi minimal kohor i zbatueshëm është 9/muaj dhe ***çështja rezulton të ketë përfunduar brenda këtij afati.***

(iv) **2 çështje** tek tabela nr. 9, e kategorisë "*kundërvajtje penale*", dhe konkretisht çështjet me nr. rendor 4 dhe 7, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar në pikën 5/g të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim, duke e tejkaluar atë me 2 muaj e 5 ditë dhe 3 muaj e 17 ditë.

(v) **1 çështje** tek tabela nr. 10, e kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*", dhe konkretisht çështja me nr. rendor 100, e cila ka përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(vi) **2 çështje** tek tabela nr. 12, e kategorisë "*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*", dhe konkretisht çështjet me nr. rendor 12 dhe 13, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(vii) **1 çështje** tek tabela nr. 14, e kategorisë "*juridiksion fillestar*", dhe konkretisht çështja me nr. rendor 65, e cila ka përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (16 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (274 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar rreth 6 % (5.83 %) të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor në Gjykatën e Apelit, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 6 %, pavarësisht ngarkesës së lartë në punë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdesin maksimal për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afateve të shkurtra dhe në 94 % të tyre duke respektuar standardin minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet e lartë, duke u pikëzuar me 5 pikë.*

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht:

(i) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"civile të përgjithshme me palë kundërshtare",* koha mesatare rezulton të jetë 102 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6/muajsh.

(ii) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"civile të përgjithshme pa palë kundërshtare",* koha mesatare rezulton të jetë 44 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 4/muajsh.

(iii) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"familjare me palë kundërshtare",* koha mesatare rezulton të jetë 40 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6/muajsh.

(iv) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"marrëdhënie pune",* koha mesatare rezulton të jetë 44 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6/muajsh.

(v) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"krime",* koha mesatare rezulton të jetë 88 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 dhe 9/muajsh.

(vi) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"kundërvajtje",* koha mesatare rezulton të jetë 61 ditë, pra ***1 ditë më e gjatë*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2/muajsh, Nëse do të llogaritim që prej muajve ka 31 ditë, koha mesatare për këtë kategori rezulton e barabartë me standartin minimal kohor.

(vii) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"kërkesa penale të hetimit paraprak",* koha mesatare rezulton të jetë 39 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar prej 2/muajsh.

(viii) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"seancë paraprake",* koha mesatare rezulton të jetë 26 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2/muajsh.

(ix) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë",* koha mesatare rezulton të jetë 36 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2/muajsh.

(x) Në lidhje me çështjet e kategorisë *"juridiksion fillestar",* koha mesatare rezulton të jetë 45 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6/muajsh.

Sa më sipër, rezulton se vetëm për një prej kategorive, përkatësisht kategorinë e çështjeve *"kundërvajtje",* koha mesatare rezulton të jetë më e gjatë se standardi minimal kohor. Megjithatë, rezulton se edhe për këtë kategori çështjesh, afati është tejkaluar vetëm me 1 (një) ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe nuk zë peshë për volumin e madh të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari si relator. Nga ana tjetër, nëse do të llogaritim që një prej muajve ka 31 ditë, koha mesatare për këtë kategori rezulton e barabartë me standartin minimal kohor. Rrjedhimisht, konkludohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është ***më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve***.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pavarësisht volumit të çështjeve, specifikave të gjykimit në apel në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për zhvillimin e gjykimit brenda afateve të shkurtra, duke treguar shkallë shumë të lartë aftësie.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është "Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve", duke u pikëzuar me 5 pikë.*

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relator (395), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2021 (537) është rreth 74 % (73,5 %), përqindje e cila sipas Metodologjisë, pikëzohet me 2/pikë.

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtari ka shpjeguar se për shkak të vendimmarrjes së KPK, është bërë rishortimi i dosjeve të dy gjyqtarve, duke i kaluar në cilësinë e relatorit, përkatësisht në muajin Qershor 2021 një numër prej 105 çështjesh dhe në muajin Tetor 2021 një numër prej 96 çështjesh.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 175 çështje[57]. Nga ana tjetër, shkronja k) e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimi, ka përcaktuar *se kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale respektivisht në masën 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate*. Në rastin konkret gjyqtari subjekt vlerësimi për një periudhë prej 3 muajsh, brenda periudhës së vlerësimit, rezulton se ka ushtruar njëkohësisht funksion drejtues në cilësinë e zëvendëskryetarit të gjykatës[58], çka nënkupton një ngarkesë sasiore gjatë vitit prej jo më pak se 153 çështje me palë kundërshtare.

Gjyqtari rezulton se, gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 395 çështje si relator, *nga të cilat rreth 176 çështje[59] janë me palë kundërshtare*, duke tejkaluar në këtë mënyrë standardin minimal të ngarkesës me 23 çështje, ose 15 %.

Sa i përket shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtari të cilat kanë ndikuar në rendimentin e përfundimit të çështjeve, rezulton se në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2021, janë larguar nga

---

[57] Ne pikën 1, shkronjat h) dhe i) të vendimit të KLD nr. 260/2011, parashikohet se :" 3. Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë h. Gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës penale, si relator, jo më pak se 150 gjykime çështjesh penale. i. Gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, si relator, jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile".

[58] Gjyqtari {…} ka ushtruar për rreth 3 muaj funksionin drejtues si zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit Durrës, pas shkarkimit nga detyra të zëvendëskryetarit të gjykatës z. Izet Dushaj me vendimin nr. 451, datë 23.09.2021 të KPK.

[59] Referuar tabelave me të dhënat statistikore, në këtë përllogaritje janë përfshirë: çështjet që i përkasin tabelës 1, 3, 7, 8, 9, 11, çështjet me objekt "lëshim urdhër mbrojtje" të cilat janë përfshirë në tabelën nr. 2, ndërkohë që i përkasin tabelës nr. 3, si dhe çështjet me objekt "kundërshtim vendim i ATP/pavlefshmëri akti" që i përkasin tabelës 14.

detyra dy gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Durrës, çka ka sjellë si pasojë rishortimin e çështjeve të tyre në muajt qershor dhe tetor 2021, duke shtuar numrin e çështjeve të caktuara gjyqtarit subjekt vlerësimi me 201 çështje. Nëse do të përllogarisim rendimentin e përfundimit të çështjeve referuar vetëm çështjeve të caktuara gjyqtarit {…}, duke zbritur nga numri total i çështjeve të caktuara (537), çështjet e caktuara rishtas pas rishortimit nga gjyqtarët e tjerë në gjysmën e dytë të vitit që përbën periudhën e vlerësimit (201) çështje, çka ka rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën e punës së gjyqtarit**,** atëherë rendimenti i përfundimit të çështjeve do të rezultonte në masën 90 %.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, veçanërisht :

(i) të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 395 çështje si relator, *nga të cilat 176 çështje janë me palë kundërshtare*, duke tejkaluar treguesin sasior në fuqi sipas "Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore" miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së me 15 %;

(ii) ngarkesës së tij si anëtar (*ka përfunduar 761 çështje në këtë cilësi*);

(iii) numrit 21 të çështjeve të caktuara për të gjykuar në gjykata të ndryshme nga ajo në të cilën gjyqtari ushtron funksionin si dhe;

(iv) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të larguar nga detyra, në 6/mujorin e dytë të vitit që përbën periudhën e vlerësimit me 201 çështje të cilat përbëjnë rreth 37 % të totalit të çështjeve të caktuara gjatë vitit,

vlerësohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtari, pavarësisht se rezulton të jetë 90 % që sipas Metodologjisë pikëzohet me 6 (gjashtë) pikë, duhet të pikëzohet një shkallë më lart se ajo, duke u pikëzuar me 8 (tetë) pikë. Kjo pasi referuar Metodologjisë së Pikëzimit, shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit lidhen me ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit përfshirë edhe çështjet e caktuara në gjykata të tjera dhe rritjen e papritur të volumit të çështjeve, ngarkesë e cila nga ana tjetër nuk e ka penguar gjyqtarin të tejkalojë standardin sasior në fuqi. Por ky tejkalim nuk rezulton mbi 50% të standardit sasior, pasi konstatohet se 219 çështje të shqyrtuara, janë kërkesa pa palë kundërshtare.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi*: Referuar sa më sipër, ky tregues pikëzohet me 8 pikë, pasi edhe pse gjyqtari ka gjykuar një numër relativisht të lartë çështjesh në cilësinë e relatorit dhe anëtarit, nuk rezulton të ketë tejkaluar standardin sasior minimal për çeshtjet me palë kundërshtare në masën 50%, për të justifikuar pikëzimin maksimal.*

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është si më poshtë:

(i) për çështje të kategorisë *"civile të përgjithshme me palë kundërshtare"* koha mesatare e arsyetimit është 32 ditë, pra ***12 ditë më e gjatë se afati procedural*** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

(ii) për çështje të kategorisë *"civile të përgjithshme pa palë kundërshtare"* koha mesatare e arsyetimit është 29 ditë, ***pra 9 ditë më e gjatë se afati procedural*** 20

ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.[60]

(iii) për çështje të kategorisë *"familjare me palë kundërshtare"* koha mesatare e arsyetimit është 25 ditë, pra ***5 ditë më e gjatë se afati procedural*** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

(iv) për çështje të kategorisë *"marrëdhënie pune"* koha mesatare e arsyetimit është 27 ditë, pra ***7 ditë më e gjatë se afati procedural*** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

(v) për çështje të kategorisë *"krime"* koha mesatare e arsyetimit është 23 ditë, pra ***më e shkurtër*** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.

(vi) për çështje të kategorisë *"kundërvajtje"* koha mesatare e arsyetimit është 33 ditë, pra ***3 ditë më e gjatë*** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.

(vii) për çështje të kategorisë *"kërkesa penale të hetimit paraprak"* me objekt sipas nenit 228, 248, 260 dhe 261 të K. Pr. Penale, koha mesatare e arsyetimit është 11 ditë, pra ***1 ditë më e gjatë*** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K. Pr. Penale.

(viii) për çështje të kategorisë *"kërkesa penale të hetimit paraprak"* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 30,5 ditë, pra ***0.5 ditë më e gjatë*** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.

(ix) për çështje të kategorisë *"seancë paraprake"* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 27 ditë, pra ***më e shkurtër*** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.

(x) për çështje të kategorisë *"kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë"* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit koha mesatare e arsyetimit është 19 ditë, pra ***më e shkurtër*** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.

(xi) për çështje të kategorisë *"juridiksion fillestar"* koha mesatare e arsyetimit është 16 ditë, pra ***më e shkurtër*** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Në tërësi, afati i arsyetimit të vendimit rezulton më i gjatë se afati procedural i parashikuar nga dispozitat procedurale respektive për shumicën e kategorive të çështjeve (për 7 nga 11 kategori). Po ashtu nga 7 kategoritë për të cilat koha e arsyetimit rezulton më e gjatë se afati procedural, për 3 (tre) prej tyre, tejkalimi i kohës mesatare të arsyetimit është me vetëm 0.5, 1 dhe 3 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm duke konsideruar ditët e pushimit javor të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Për pasojë, për këto tri kategori koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor do të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural. Për pasojë, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, rezulton më e gjatë se afati procedural për 4 nga 11 kategoritë e çështjeve, tregues i cili sipas Metodologjisë kategorizohet si "*Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*".

---

[60] *Për efekt të kësaj llogaritje, nuk janë përfshirë çështjet me objekt "Lëshim urdhër mbrojtje", të cilat i përkasin tabelës nr. 3 "Familjare me palë kundërshtare", e rrjedhimisht janë përfshirë tek kjo e fundit.*

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar veten në nivelin *"shumë të lartë",* duke argumentuar se ka bërë përpjekjet maksimale për të respektuar afatet procedurale të arsyetimit. Pamundësia për të arsyetuar në kohë një pjesë të tyre është justifikuar prej tij me shkaqet si vijon: planifikimin e seancave gjyqësore në pothuajse të gjithë ditët e javës; natyrën komplekse në disa lloj çështjesh themeli; rritjen e paparashikueshme të volumit për shkak të qenies në listën e gjyqtarëve të gatshëm; caktimin nga KLGJ-ja për gjykime në Gjykatën e Apelit Shkodër, planifikuar në kalendar çdo dy javë; periudhën Maj-Qershor 2021, që përkon me periudhën e përmbylljes së procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij si subjekt; periudhën e fund vitit 2021, që përkon me infektimin e tij me Covid.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar në koeficient jo më shumë se 20 %.

Në rastin konkret, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, rezultoi "*më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*", duke u pikëzuar me 12 pikë. Duke konsideruar shpjegimet e dhëna nga gjyqtari dhe të dhënat që rezultojnë nga tërësia e burimeve të vlerësimit lidhur me *(i)* ngarkesën e lartë në punë të tij në cilësinë e relatorit dhe anëtarit, *(ii)* angazhimin e tij për gjykimin e çështjeve në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushton funksionin, *(iii)* angazhimin e tij në kohë në procesin e rivlerësimit kalimtar gjatë periudhës së vlerësimit, *(iv)* rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të tjerë si dhe *(v)* tejkalimin e afatit të arsyetimit për 4 kategoritë e çështjeve me 5 deri në 12 ditë, vlerësoj se ka vend që gjyqtari të pikëzohet me një nivel më të lartë se sa rezulton nga burimet e vlerësimit për këtë tregues.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pavarësisht se rezulton "*më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*" dhe përkon me 12 pikë sipas Metodologjisë, duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi dhe konkretisht me 15 pikë, duke konsideruar si faktorë që ka ndikuar në këtë tregues ngarkesën tepër të lartë në punë të gjyqtarit (rezulton se ka përfunduar 395 çështje ne cilësinë e relatorit dhe 761 çështje në cilësinë e anëtarit) rritjen e papritur të volumit të çështjeve në periudhën e vlerësimit, angazhimin e në gjykimin e çështjeve të caktuara në gjykata të tjera të apelit, impenjimin në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar[61] si dhe tejkalimin e kohës mesatare të arsyetimit maksimalisht me 12 ditë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 15 pikë.*

[61] *Procesi i rivlerësimit kalimtar për gjyqtarin {…} rezulton se ka përfunduar me vendimin nr. 394, datë 07.06.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi të dhënat e pasqyruara nuk përmbajnë vetëm numrin e seancave gjyqësore, por numrin e përbashkët të tyre me seancat përgatitore. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen ne rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short*.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore referuar çështjeve me palë kundërshtare, të përzgjedhura me short, është ***2 seanca gjyqësore***.

Po kështu, nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Në dy çështje për të cilat gjykimi ka përfunduar për më tepër se një seancë[62], rezulton se shkak ka qenë mos formimi i trupit gjykues, mosparaqitja e palëve për arsye shëndetësore apo njoftimi i të pandehurit me qëllim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe jo mos marrja e masave organizative dhe procedurale nga ana e gjyqtarit relator.

Në dy nga gjashtë çështjet në të cilat gjykimi ka përfunduar me më tepër se një seancë, të gjitha seancat nuk janë zhvilluar për shkaqe të pavarura nga ana e gjyqtarit relator. Ndërkohë, konstatohet se seancat gjyqësore janë caktuar në një distancë kohore 21 ditë, 30 ditë, 34 ditë, 7 ditë[63], 28 ditë, 21 ditë dhe 21 ditë[64].

Pra në tërësi konstatohet se seancat nuk janë zhvilluar në ditën e planifikuar për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit dhe në një rast për të mundësuar njoftimin e të pandehurit me qëllim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor[65].

Konstatohet gjithashtu se çështjet përgjithësisht kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor nga momenti i nxjerrjes së çështjes në seancë gjyqësore.

KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, për treguesin e "numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive", rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 2

---

[62] *Çështja e përfunduar me vendimin nr. 421/1282, datë 08.07.2021 dhe çështja e përfunduar me vendimin nr. 311/64, datë 25.02.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës.*
[63] *Çështja e përfunduar me vendimin nr. 421/1282, datë 08.07.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës.*
[64] *Çështja e përfunduar me vendimin nr. 311/64, datë 25.02.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës.*
[65] *Çështja e përfunduar me vendimin nr. 311/64, datë 25.02.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës.*

seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

> ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues rezulton shumë e lartë pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2, e rrjedhimisht pikëzohet me 15 pikë.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se, përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.[66] Rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas nenit 461 të K.Pr.Civile në çështjet civile[67] apo pa pjesëmarrjen e të pandehurit por në praninë mbrojtësit referuar nenit 416/a dhe 351 të K. Pr. Penale[68], shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar *(si shkallë e dytë në 6 çështjet e përzgjedhura me short),* dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese *(njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj*.).

Përgjithësisht, seancat kanë filluar në orarin e planifikuar. Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

---

[66] *Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile dhe neni 426 i K.Pr.Penale.*

[67] *Çështja që i përket vendimit nr. 152/458 datë 16.03.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës.*

[68] *Çështja që i përket vendimit nr. 311/64, datë 25.02.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës.*

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është "shumë e lartë", dhe pikëzohet me 20 pikë.*

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur kryesisht rendin kronologjik (sipas datës së aktit). Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, vendimin e caktimit të seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, kërkesat e tyre dhe konkluzionet me shkrim aty ku ka të tilla[69], procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin e arsyetuar.

KONKLUZIONI

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata *(njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar i arsyetuar*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesat e palëve për shtyrjen e seancës, diskutimet përfundimtare të palëve*).

KONKLUZIONI

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

---

[69] Çështja që i përket vendimit nr. 421/1282, datë 08.07.2021 dhe nr. 311/64, datë 25.02.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit **KRITERI** **AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT**	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, rezulton të jenë regjistruar dhe trajtuar nga ana e ILD-së 5 (pesë) ankesa, si vijon:

(i) Ankesa e z. Sh.C, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 2087 prot., datë 19.04.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime të cilat nuk lidhen me veprime/sjellje të magjistratit gjatë apo jashtë ushtrimit të detyrës. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 2087/3 prot. datë 11.06.2021 *"Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z. Sh.C".*

(ii) Ankesa e z. Sh.C, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 2005 prot., datë 12.04.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime se Gjykata e Apelit Durrës, me trup gjykues të përbërë ndër të tjerë prej gjyqtarit {…}, ka realizuar gjykimin në dhomë këshillimi, duke mos caktuar asnjë seancë të vetme për të dëgjuar palët. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 2005/3 prot. datë 25.05.2021 *"Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z. Sh.C."*

(iii) Ankesa e z. L.Q, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 3115 prot., datë 08.07.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime se vendimi i datës 06.07.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës, me relator gjyqtarin {…}, ishte i paracaktuar dhe se është marrë në

kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, edhe pse nuk është vendim korruptiv. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke vlerësuar se sjellja dhe veprimet e magjistratit në shqyrtimin e çështjes nuk janë të natyrës që të përbëjnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të neneve 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1382/1 prot. datë 03.06.2022 *"Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z.* L.Q*".*

(iv) Ankesa e z. S.V, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 3659 prot., datë 21.09.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime se Gjykata e Apelit Durrës, me trup gjykues të përbërë ndër të tjerë prej gjyqtarit {…}, ka marrë vendimin me nr. 412 datë 06.07.2021, në kundërshtim me nenin 227 të K. Pr. Civile, duke keqinterpretuar qëllimisht këtë dispozitë ligjore për llogari të palës kundërshtare, e rrjedhimisht duke cenuar të drejtat e ankuesit si pronar. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke vlerësuar se pretendimet e ankuesit në thelb lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe të vlerësimit të provave, kompetencë e cila është ekskluzive e gjykatës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1120/1 prot. datë 03.06.2022 *"Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z.* S.V*".*

(v) Ankesa e z. I.M, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 3178 prot., datë 13.07.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime se Gjykata e Apelit Durrës, me trup gjykues të përbërë ndër të tjerë prej gjyqtarit {…}, ka dhënë vendimin nr. 3440, datë 10.06.2021, duke shpërdoruar detyrën dhe duke bashkëpunuar në formën e organizatës së strukturuar kriminale. Konkretisht, sipas ankuesit, magjistrati së bashku me gjyqtarët e tjerë veprojnë si organizatë e strukturuar kriminale dhe duke fshehur me dashje provat etj... Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke vlerësuar se pretendimet e ankuesit nuk rezulton të jenë me natyrë disiplinore sipas parashikimeve të neneve 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1337/3 prot. datë 03.06.2022 *"Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z. I.M".*

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtarit të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, të cilat janë trajtuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë evidentuar elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë ne funksion.

Referuar të dhënave lidhur me rastet e pranimit të kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, rezulton se në 6 raste[70] kërkesat e palëve janë pranuar dhe gjyqtari është përjashtuar nga gjykimi për shkak se ka marrë pjesë në gjykimin e çështjeve të cilat kanë lidhje me çështjen në gjykim (*të tilla si shqyrtimi i kërkesave të fazës së hetimit paraprak, gjykimin e çështjes në rastin e kthimit të saj për rigjykim, etj.*). Në këto raste vendimi i përjashtimit

---

[70] *Vendimet nr. 39, datë 15.02.2021, nr. 232, datë 30.06.2021, nr. 328, datë 10.11.2021, nr. 368, datë 04.12.2021, nr. 376, datë 09.12.2021, nr. 565, datë 13.12.2021.*

konsiston në konstatimin e prezencës së shkaqeve të parashikuara nga neni 72, pika 4[71] i K.Pr.C ose neni 18, pika 1, shkronja a) në lidhje me 15, pika 1 dhe 2[72] të K.Pr.P. Në një rast shkaku i përjashtimit konsiston në prezencën e një tjetër shkaku dhe konkretisht të njohjes së tij me bashkëshortin e palës së paditur[73]. Në një rast tjetër, kërkesa është pranuar por ndërkohë rezulton se gjyqtari ka paraqitur paraprakisht dorëheqjen, e cila nuk rezulton të jetë shqyrtuar nga kryetari i gjykatës dhe për pasojë, gjykimi për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim ka vijuar duke përfunduar me vendim pranimi[74].

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit, në kuadër të shpjegimeve mbi treguesin "*3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.",* lidhur me këtë aspekt ka shpjeguar se : "*Në lidhje me vendimet me të cilat janë pranuar kërkesat për përjashtim sqaroj se pjesa më e madhe e këtyre vendimeve i përkasin periudhës pas zgjedhjes sime si zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit Durrës më datë 28.09.2021, duke ushtruar njëkohësisht edhe funksionin e kryetarit në detyrë, dhe për shkak të shpejtësisë që impononin çështjet në gjykim edhe pse shkaku i përjashtimit edhe në vlerësimin tim ishte në kushte pranueshmërie, për të mundësuar gjykimin sa më të shpejtë të çështjes, i është bërë me dije palëve pjesëmarrëse në proces shkaku për tu iniciuar më pas procedura e përjashtimit.*".

Duke konsideruar shpjegimet e gjyqtarit dhe kohën e zgjedhjes së tij si zëvendëskryetar i gjykatës, rezulton se nga 7 kërkesa të pranuara për përjashtimin e tij, pa përfshirë këtu rastin në të cilin rezultoi se ai ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, 2 prej tyre i përkasin periudhës në të cilën ai nuk ka ushtruar njëkohësisht funksionin e drejtuesit të gjykatës dhe 5 të tjera i përkasin kësaj periudhë, pra pas datës 28.09.2021. Në këto 7 raste, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore me të cilat është pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari të ketë dhënë dorëheqjen nga gjykimi pavarësisht se shkaqet e ngritura përbëjnë shkak për heqjen dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes në referim të nenit 17 të K.Pr.P dhe 72 të K.Pr.C.

Duke konsideruar shpjegimet e gjyqtarit lidhur me qëllimin për të cilin ai nuk ka hequr dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve për të mos ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve në raport me parashikimet ligjore procedurale që përcaktojnë rastet në të cilat gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi si dhe mungesës së pasojave nga sjellja e tij, pasi nuk rezultojnë të dhëna që kjo sjellje të ketë vënë në rrezik parimin e paanshmërisë, duket sikur gjyqtari ka "shmangur" zbatimin e institutit procedural të "heqjes dorë nga gjykimi", në rastet kur janë prezent shkaqe që pengojnë pjesëmarrjen e tij në procedim.

---

[71] *Në nenin 72, pika 4 të K.Pr.Civile parashikohet se :" Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:…. 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërës apo tjetrës palë;".*

[72] *Në nenin 15, pika 1 dhe 2 të K.Pr.P paeashikohet se :" 1. Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim apo rishikim pas prishjes së vendimit. 2. Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. Gjyqtari që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit të seancës paraprake në të njëjtin procedim".*

[73] *Vendim nr. 574, datë 14.12.2021.*

[74] *Vendimi nr. 75, datë 04.03.2021.*

Duke aplikuar heqjen dorë nga gjykimi për rastet ku, sikurse vetë gjyqtari shpjegon, ka qenë i vetëdijshëm për prezencën e shkaqeve ligjore të zbatimit të këtij instituti, duket se gjyqtari nuk ka treguar kujdesin e duhur për të minimizuar rastet kur do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes. Pavarësisht qëllimit të tij, i cili siç gjyqtari ka shpjeguar, është bërë në dobi të eficensës së gjykimit të çështjeve (për 5 nga shtatë rastet e shqyrtuara), kjo sjellje duket se përmban elementë të cilët duhet të vlerësohen në kuadër të etikës, në angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion të gjyqtarit. Duke iu referuar edhe Kodit të Etikës Gjyqësore, në kapitullin II, seksioni B, pika 7, shkronja dh), parashikohet si një ndër elementët që lidhen me parimin e paanshmërisë, detyrimi i gjyqtarit që *brenda kufijve të arsyeshëm, të veprojë në mënyrë të tillë që të minimizohen rastet ku do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes.* Ky aspekt ka të bëjë me detyrimin e gjyqtarit për tu sjellë në mënyrë të tillë që të mos bëhet shkak për të krijuar tek palët në proces asnjë përshtypje që mund të diktojë ngritjen e pretendimeve për përjashtimin e gjyqtarit. Është sjellja e gjyqtarit ajo që ka rëndësi në shmangien e perceptimit mbi anshmërinë e tij në gjykimin e një çeshtjeje. Në rastin konkret sjellja e gjyqtarit subjekt vlerësimi nuk është e tillë që të ketë ndikuar tek palët për të kërkuar përjashtimin e tij, por përbën një sjellje të karakterit formal, pasi shkaqet e mospjesëmarrjes së tij në gjykim kanë qenë prezentë dhe të paktën në 6 nga 7 raste, gjyqtari është përjashtuar nga gjykimi për shkak të pengesave ligjore procedurale të tij për të marrë pjesë në gjykim. Vetëm në një rast shkaku u përjashtimit lidhet me njohjen e tij me palët, por ky rast i vetëm, duke konsideruar shpjegimet e tij se arsyeja e kësaj sjellje ka qenë për të mos shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjeve, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të konkluduar se ka cenuar shkallën e aftësisë së tij në drejtim të treguesit të *angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.*

Nga përmbajtja e vendimeve të pranimit të kërkesës për përjashtim, në një rast bëhet fjalë për "lidhje miqësore", fakte të cilat gjyqtari rezulton t'i ketë bërë prezent për palët, madje përjashtimi është kërkuar nga vetë pala me të cilën është pranuar kjo lidhje. Relatimi dhe reklamimi i shkakut të përjashtimit për palët në gjykim, pavarësisht se gjyqtari nuk ka paraqitur kërkesë "për heqje dorë nga gjykimi", është tregues i reagimit të gjyqtarit për të shmangur perceptimin objektiv tek palët të dukjes si i anshëm, sjellje kjo që nuk duhet të afektojë negativisht etikën në punë të gjyqtarit. Ndërsa në vendimet e tjera të përjashtimit që i referohen papajtueshmërisë për pjesëmarrje në procedim, apo të dhënies së mendimit për faktet objekt gjykimi, duket që instituti i "heqjes dorë nga gjykimi" nuk është përdorur vetëm në aspektin formal, pasi gjyqtari duke pranuar edhe vetë në formularin e vlerësimit që shkaku i përjashtimit ka qëndruar, ka vlerësuar me përparësi duke i dhënë rëndësi shqyrtimit pa vonesa të çështjes dhe jo llojit të instrumentit që duhej të përdorej për tu përjashtuar nga gjykimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, rezulton të jenë regjistruar dhe trajtuar nga ana e ILD-së 5 (pesë) ankesa, të cilat janë evidentuar në treguesin më sipër. Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit. Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën 721/24 prot., datë 24.03.2022, konkludohet se : *a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e tij.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij.

Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për periudhën 01 janar 2021 – 31 dhjetor 2021, janë paraqitur 15 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, nga të cilat 9[75] janë pranuar duke u bazuar në nenet 72, pika 4 dhe 6 të K. Pr. Civile dhe 15, pika 1 të K. Pr. Penale. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 39 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 35 janë pranuar.

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtari ka referuar se vendimet me të cilat janë pranuar kërkesat për përjashtim i përkasin përgjithësisht *(konkretisht pesë prej tyre)* periudhës pas zgjedhjes si zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit Durrës më datë 28.09.2021, duke pasjellë njëkohësisht ushtrimin e funksionit të kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës. Rrjedhimisht, gjyqtari ka sqaruar se edhe pse shkaku i përjashtimit ka rezultuar në kushte provueshmërie në vlerësim të tij, për të mundësuar gjykimin sa më të shpejtë të çështjes, është vlerësuar të vijohet me procedurën e përjashtimit.

Referuar vendimeve të përcjella nga Gjykata e Apelit Durrës me shkresën nr. 393/1 prot., datë 08.04.2022, rezulton si më poshtë:

(i) ***Vendimi nr. 39, datë 15.02.2021***, nëpërmjet të cilit është shqyrtuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit {…} i përket periudhës në të cilën ai nuk ka ushtruar funksionin e drejtuesit të gjykatës[76]. Përjashtimi i trupit gjykues, pjesë e të cilit ka qenë edhe gjyqtari {…} rezulton se bazohet në shkaqe procedurale, për shkak të një vendimmarrje të mëparshme që ka

[75] *Nëpërmjet shkresës nr. 393/1 prot., datë 08.04.2022 Gjykata e Apelit Durrës ka vënë në dispozicion 10 vendime por rezulton se vendimi nr. 245, datë 26.07.2021 është një vendim për pushimin e gjykimit të çështjes, pra nuk përbën një vendim që lidhet me një kërkesë të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit dhe për pasojë nuk konsiderohet si burim lidhur me vlerësimin e treguesit përkatës.*

[76] *Deri në datë 28.09.2021 funksionin drejtues në Gjykatën e Apelit Durrës e ka ushtruar kryetari i saj z. Desart Avdulaj dhe zëvendëskryetari z. Iset Dushaj, i cili është shkarkuar nga KPK me vendimin nr. 451, datë 23.09.2021.*

lidhje me çështjen ne shqyrtim. Kërkesa e palëve është pranuar bazuar në parashikimet e nenit 72, pika 4 të K.Pr.C;

(ii) ***Vendimi nr. 75, datë 04.03.2021***, nëpërmjet të cilit është shqyrtuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit {…} i përket periudhës në të cilën ai nuk ka ushtruar funksionin e drejtuesit të gjykatës. Përjashtimi i trupit gjykues, pjesë e të cilit ka qenë edhe gjyqtari {…} rezulton se bazohet në shkaqe procedurale, për shkak të një vendimmarrje të mëparshme që ka lidhje me çështjen ne shqyrtim. Kërkesa e palëve është pranuar. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se gjyqtari ka paraqitur dorëheqjen nga gjykimi i çështjes por shqyrtimi i kërkesës ka vijuar dhe ka përfunduar me vendimin përkatës, pasi deri në afatin e shqyrtimit të saj kryetari i gjykatës nuk ishte shprehur për kërkesën për heqje dorë të gjyqtarit. Në kushtet kur gjyqtari ka paraqitur dorëheqjen para se të merret një vendim për përjashtimin e tij, kjo çështje nuk duhet të konsiderohet në numrin e kërkesave për përjashtimin e tij[77].

(iii) ***Vendimi nr. 232, datë 30.06.2021,*** nëpërmjet të cilit është shqyrtuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit {…}, i përket periudhës në të cilën ai nuk ka ushtruar funksionin e drejtuesit të gjykatës. Përjashtimi i tij nga gjykimi rezulton se bazohet në shkaqe procedurale, për shkak të një vendimmarrje të mëparshme që ka lidhje me çështjen ne shqyrtim. Kërkesa e palëve është pranuar.

(iv) ***Vendimet nr. 328, datë 10.11.2021, nr. 368, datë 04.12.2021, nr. 376, datë 09.12.2021 dhe nr. 565, datë 13.12.2021***, përbëjnë raste të pranimit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarit, për shkaqe procedurale që konsistojnë në pjesëmarrjen e tij në proceseve gjyqësore të mëparshme të cilat kanë lidhje me çështjet në shqyrtim (*të tilla si shqyrtimi i kërkesave të fazës së hetimit paraprak, etj.*).

(v) ***Vendimi nr. 574, datë 14.12.2021*** nëpërmjet të cilit rezulton të jetë pranuar kërkesa e palës për përjashtimin e gjyqtarit {…} për shkak të lidhjeve miqësore me një prej palëve të paditura. Rezulton se ky shkak është konfirmuar edhe nga gjyqtari i cili ka shprehur mendim se kërkesa për përjashtimin e tij duhet të pranohet. Nuk rezulton nga përmbajtja e vendimit që gjyqtari të ketë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes.

(vi) ***Vendimi nr. 361, datë 12.10.2021*** nëpërmjet të cilit rezulton të jetë disponuar për pranimin e kërkesës së palës për përjashtimin e gjyqtarit, por gjithë pjesa arsyetuese e vendimit argumenton për pabazueshmërinë e pretendimeve për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke qenë se arsyetimi i vendimit rrëzon shkaqet e vëna në themel të kërkesës për përjashtim, pavarësisht disponimit të gjykatës në dispozitivin e vendimit, nuk mund të konsiderohet si kërkesë e pranuar për përjashtimin e tij dhe për pasojë, nuk mund të konsiderohet në vlerësimin e treguesit përkatës.

Sa më sipër, rezulton se numri i kërkesave të pranuara për përjashtimin e gjyqtarit është 7 (shtatë), nga të cilat 6 (gjashtë) lidhen me shkaqe procedurale të cilat pengojnë pjesëmarrjen ne gjykim (*për shkak se gjyqtari ka shqyrtuar çështje të cilat lidhen me ato objekt shqyrtimi*) dhe 1 (një) lidhet me ekzistencën e njohjes së tij me palët, rast në të cilin vetë gjyqtari ka konfirmuar faktin dhe ka shprehur dakordësinë për tu përjashtuar nga gjykimi i çështjes. Madje shkaku i përjashtimit rezulton të jetë reklamuar prej gjyqtarit.

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar nëse numri i kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është "tejet i lartë", vlerësuesi rast pas rasti nuk përqëndrohet vetëm në numrin e vendimeve të pranuara për përjashtimin, por analizon edhe tregues të tjerë të dalë

---

[77] *Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se :"Gjyqtari nuk penalizohet nëse para vendimit të përjashtimit, ai ka hequr dorë paraprakisht nga gjykimi i çështjes, por kërkesa e tij nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës.".*

nga burimet e vlerësimit, e mbi të gjitha sjelljen e gjyqtarit ndaj reklamimit të shkakut të përjashtimit. Gjyqtari duhet të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedura në të cilat ai në fakt nuk është në gjendje të vendosë çështjen në mënyrë të paanshme, apo në procedura në të cilat mund t'i duket një personi të arsyeshëm që gjyqtari nuk mund të jetë i paanshëm. Ajo që ka rëndësi është sjellja e gjyqtarit ndaj të dukurit i paanshëm. Në referim të parimit kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, duke mbajtur në konsideratë dhënat burimore për numrin e kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, shkaqet për të cilat është vendosur përjashtimi dhe sjelljen e gjyqtarit ndaj shkakut të përjashtimit, numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet i pa konsiderueshëm. Arrihet në këtë konkluzion duke vlerësuar se *(i)* shkaqet e përjashtimit të gjyqtarit në 6 nga 7 kërkesat e pranuara për përjashtimin e tij lidhen me shkaqe procedurale (pjesëmarrja në gjykime të tjera që lidhen me çështjet konkrete); *(ii)* në rastin e konfliktit të interesit kërkesa për përjashtim është iniciuar pasi gjyqtari e ka reklamuar shkakun e përjashtimit; *(iii)* numri i kërkesave të pranuara për përjashtimin e tij në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari në periudhën e vlerësimit (*395 çështje të përfunduara si relator*) përbën një numër të papërfillshëm.

Pavarësisht numrit të kërkesave të pranuara për përjashtimin e gjyqtarit i cili në kuptim të këtij treguesi vlerësohet i papërfillshëm dhe nuk rezultojnë shkaqe të cilat mund të vlerësohen në drejtim të paanësisë së gjyqtarit dhe posaçërisht dy treguesve të këtij aspekti, të dhënat që rezultojnë lidhur me sjelljen e gjyqtarit në raport me rastet në të cilat ai është përjashtuar nga gjykimi ndërkohë që ka pasur pengesë për të marrë pjesë në gjykimin e një çështje, referuar parashikimeve të ligjit procedural, janë konsideruar në kuadër të vlerësimit të treguesit "*3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion."*

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si "*I pakonsiderueshëm*".

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet "i pakonsiderueshëm", duke u pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit **KRITERI** **ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit ne drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, dhe i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet kujdesi i tij për të bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është "E lartë", duke u pikëzuar me 15 pikë.*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 15 pikë.*

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik evidentohet se gjyqtari {…}, përgjatë vitit kalendarik 2021, ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit vetëm në aktivitetin trajnues të datës 17 dhjetor 2021, në të dy sesionet e tij, konvertuar në numër ditësh, përkatësisht 1 (një) ditë. Ndërkohë, ligji nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"* i ndryshuar, në pikën 3 të nenit 5 të tij ka parashikuar se periudha e e formimit vazhdues duhet të jetë jo më pak se pesë ditë të plota dhe jo më shumë se 40 ditë të plota, në vit. Rrjedhimisht, sipas Metodologjisë së Pikëzimit, e cila përcakton se gjyqtari që ka marrë pjesë në më pak se 15 ditë të plota ose më shumë se 120 ditë plota përgjatë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit/më pak se 30 ditë plota ose më shumë se 200 ditë të plota përgjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit vlerësohet me 4 pikë, në mënyrë proporcionale konkludohet se gjyqtari në periudhën 1 vjecare të vlerësimit, duhet të kishte marrë pjesë minimalisht në aktivitete trajnuese për një kohëzgjatje prej 5 ditësh.

Për sa më sipër në zbatim të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"* i ndryshuar dhe Metodologjisë së Pikëzimit, në projektraportin e vlerësimit ishte propozuar nga relatori pikëzimi me 4 (katër) pikë lidhur me këtë kriter.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtari parashtroi kundërshtimet e tij, duke u shprehur se : *".....Për vitin 2021 nuk e kam përmbushur plotësisht këtë të drejtë dhe detyrim ligjor, çka nga ana tjetër ka ndikuar dhe në vlerësimin tim për nëntreguesin e lartpërmendur. Është e gjithëpranuar se dispozitat e ligjeve përmbajnë vetëm rregullimin objektiv të rrethanave të përcaktuara shoqërore duke ju referuar karakteristikave të tyre të identifikueshme, sikundër ato duhet të përmbajnë shprehje të qarta dhe të sakta të të drejtave dhe detyrimeve. Në këtë pikëpamje edhe dispozitat e ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përmbajnë rregullimin objektiv të asaj çka përfshihet nën konceptin e statusit të magjistratit, sikundër edhe shprehjen e qartë të një prej të drejtave dhe detyrimeve që përfshihen nën këtë status, atë për ndjekjen e formimit vazhdues. Sipas ligjit, asnjë magjistrat nuk duhet t'i shmanget përmbushjes së kësaj përgjegjësie. Objeksioni im konsiston në atë nëse është i drejtë dhe i përligjur penalizimi i magjistratit në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, për shkak të mospërmbushjes në masën e duhur, për arsye objektive dhe të ligjshme, të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues përgjatë një viti kalendarik. Këtë objeksion e shtroj nisur nga fakti se ky vlerësim (vlerësimi etik dhe profesional i përshpejtuar*

i detyruar) është një nga dy vlerësimet që shërbejnë si kriter renditje dhe përparësie në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratit, çka do të thotë se një penalizim i tillë ka efekt jo vetëm në vlerësimin etik dhe profesional të magjistratit, por edhe për sa i përket së drejtës për karrierë të tij. Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk përmban rregullime mbi të cilat mund të konsiderohet e justifikueshme, jo penalizuese në vlerësimin etik dhe profesional të magjistratit, mospërmbushja në masën e duhur e detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues përgjatë një viti kalendarik. Edhe metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit nuk përmban rregullime në këtë drejtim. Mendoj se në karrierën e magjistratit, periudha e një viti kalendarik është shumë e vogël dhe mund të thuhet e papërfillshme. Nga ana tjetër, vlerësimi etik dhe profesional i përshpejtuar i detyruar është një instrument ligjor i zbatueshëm për një periudhë të përkohshme/kalimtare (deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve), që përfshin vitin e fundit kalendarik. Si rregull, referuar ligjit për statusin, magjistratët vlerësohen për periudha 3 ose 5-vjeçare, ku për sa i përket vlerësimit për nëntreguesin "Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", ligji vendos një numër tavan ditësh trajnimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, çka do të thotë se magjistrati mund të rikuperojë numrin e nevojshëm të trajnimeve brenda viteve të periudhës së vlerësimit. Për vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar magjistrati nuk e ka këtë mundësi. Ndaj, mendoj se nuk do të ishte e përligjur dhe proporcionale penalizimi i magjistratit për zhvillimin e karrierës për shkak të penalizimit të tij në vlerësimin etik profesional të përshpejtuar të detyruar pikërisht për mospërmbushjen në masën e duhur të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues përgjatë një viti kalendarik, kur ajo ka ndodhur për arsye objektive dhe të ligjshme. Thënë këtë, kam parasysh kohëzgjatjen e shkurtër të periudhës minimale të ndjekjes së detyrueshme të programit të formimit vazhdues (5 ditë), në raport me pikëzimin respektiv sipas metodologjisë së pikëzimit (20 pikë), sikundër edhe ndikimin që pikëzimi i këtij nëntreguesi ka në rezultatin e vlerësimit tërësor të kriterit të "Aftësive profesionale dhe angazhimit profesional". Referuar metodologjisë së pikëzimit, pikëzimi i këtij nëntreguesi është përcaktues në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë kriter, nivel ky që, nga ana tjetër, është përcaktues për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për periudhën përkatëse të vlerësimit. Në vlerësimin tim, parësore për gjyqtarin është përmbushja e detyrave gjyqësore, çka nuk nënkupton mospërmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore, përfshirë dhe atë të ndjekjes së programit të formimit vazhdues, detyrim ky, qëllimi i të cilit shkon në funksion të përmbushjes më së miri të detyrave gjyqësore. Për sa më sipër, objeksioni im është mospenalizimi në atë masë sa i përket vlerësimit të nëntreguesit të "Pjesëmarrjes së gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", për arsye se mospërmbushja në masën e duhur të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues ose

trajnimeve të tjera profesionale gjatë vitit 2021 ka ndodhur për shkaqe objektive dhe të ligjshme. Konkretisht, ato që në vlerësimin tim duhet të konsiderohen si shkaqe objektive dhe të ligjshme lidhur me mospërmbushjen në masën e duhur të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues ose trajnimeve të tjera profesionale përgjatë vitit 2021, janë si vijon:

a) *Angazhimi im i shtuar në përmbushjen e detyrave gjyqësore duke pasur parasysh se trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Durrës, sipas organikës 13 gjyqtarë, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, është reduktuar ndjeshëm gjatë vitit 2021. Kështu, deri në muajin maj të vitit 2021 kanë ushtruar detyrën 6 gjyqtarë (përfshirë dhe 2 gjyqtarë të skemës së delegimit të caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në periudhën e fundit të vitit 2020). Nga muaji qershor i vitit 2021 e në vijim kanë ushtruar detyrën 5 gjyqtarë (përfshirë edhe një gjyqtar tjetër nga skema e delegimit, caktuar në muajin tetor të po këtij viti). E gjithë trupa e mbetur gjyqësore ka pasur angazhim maksimal për përballimin e ngarkesës në punë, ku për shkak të formimit të trupave gjykues kemi qenë të detyruar të zhvillonim seanca gjyqësore përgjatë katër ditëve të javës, nga e hëna në të enjte. Lidhur me ngarkesën e përballuar, sikurse gjykata ka raportuar çdo tremujor, mesatarisht çdo gjyqtar ka gjykuar dhe dhënë vendim përfundimtar (përllogaritur mbi raportin mes numrit të çështjeve të gjykuara dhe numrit të gjyqtarëve që kanë ushtruar detyrën gjatë vitit 2021, pavarësisht kohëzgjatjes së ushtrimit të detyrës nga disa prej tyre) 347 çështje (penale dhe civile). Unë kam gjykuar dhe dhënë vendim për 395 çështje (penale dhe civile);*

b) *Angazhimi im i shtuar në përmbushjen e detyrave gjyqësore për shkak të caktimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykata të tjera të apelit, si në atë të Shkodrës, Korçës, Vlorës, Tiranës dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Vetëm përgjatë vitit 2021 jam caktuar për të gjykuar në 21 çështje, ndërkohë që edhe në vitet e mëparshme kam pasur caktime të tilla, ndërsa disa çështje kanë përfunduar gjatë vitit 2021. Për shkak të këtij angazhimi, të paktën dy ditë (të premte) në muaj më është dashur të gjykoj në gjykata të tjera të apelit;*

c) *Angazhimi im i shtuar për përmbushjen e përgjegjësisë së menaxhimit të përgjithshëm të gjykatës, ndërsa prej muajit shtator të vitit 2021 jam zgjedhur zëvendëskryetar i gjykatës, duke ushtruar kompetencat e kryetarit të gjykatës në mungesë të tij, ndërkohë që kam vijuar me të njëjtin angazhim përmbushjen e detyrave gjyqësore, imponuar kjo nga vetë situata e rëndë në të cilën gjykata ndodhej;*

ç) *Angazhimi im përgjatë 6 muajve të parë të vitit 2021 në procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe*

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", proces ky që ka përfunduar me vendimin nr. 394, datë 07.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky proces, për shkak të rëndësisë së tij në aspektin individual, ndërsa përcaktonte vijimin ose jo të detyrës, nuk mund të mos merrte angazhimin tim të nevojshëm, por pa shmangur ose ulur angazhimin në përmbushjen e detyrave gjyqësore. Ndërkohë kjo ngjarje, e pavarur nga vullneti im, ka koinciduar me periudhën e vlerësimit tim etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar.

Angazhimet si më sipër, më kanë penguar objektivisht të përmbush në masën e duhur detyrimin për ndjekjen e programit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës ose trajnime të tjera profesionale, ndërsa kam vlerësuar si parësore, në pikëpamje të interesit publik, përmbushjen e detyrave gjyqësore.

Nga sa më lart parashtrova, mospërmbushja në masën e duhur të detyrimit për ndjekjen e programit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës ose trajnime të tjera profesionale nuk ka ndodhur për mungesë dëshire, neglizhencë ose mospasjen e kujdesit të duhur, por për arsye objektive dhe të ligjshme, arsye për të cilat, në konsideratë dhe të angazhimit profesional të treguar, mendoj se nuk do të ishte e drejtë dhe e përligjur të penalizohem në një masë të atillë (jo proporcionale) për sa i përket vlerësimit për nëntreguesin e "Pjesëmarrjes së gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale".

Pasi dëgjoi relatoren e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarit, Këshilli vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatorit.

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim të gjyqtarit. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e trajnimit vazhdues është një detyrim që përcaktohet nga ligji, i cili gjithashtu përcakton dhe minimumin e ditëve të trajnimit që gjyqtari duhet të plotësojë brenda një viti kalendarik. Pavarësisht se gjatë periudhës 3 apo 5 vjeçare gjyqtari ka mundësi të plotësojë ditët e trajnimit të parashikuara në ligj, ndryshe nga sa pretendohet në kundërshtime, minimumi i 5/ditëve trajnimi në një vit kalendarik duhet të plotësohet, pasi vetë ligjvënësi në nenin 5 pika 3 të Ligjit "Për Statusin" parashikon : "*Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë : a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve....*" .

"Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues" është përcaktuar në nenin 76 të Ligjit "Për Statusin" si një nga indikatorët (treguesit) e vlerësimit të aftësive personale dhe angazhimit profesional të gjyqtarit. Pesha që ky indikator zë në vlerësimin e të gjithë treguesve të këtij kriteri, është përcaktuar në Metodologjinë e Pikëzimit në mënyrë të tillë që

gjyqtari që nuk plotëson minimumin e ditëve të trajnimit të kërkuara nga ligji, pra në rastin e vlerësimeve 1/vjeçare ka më pak se 5/ditë trajnim, do të pikëzohet me 4/pikë.[78]

Këshilli nuk mund të përcaktojë një pikëzim të ndryshëm nga ajo që vetë Metodologjia përcakton lidhur me këtë indikator vlerësimi, pasi me këtë akt nënligjor i ka hequr vetës të drejtën të ushtrojë diskrecion për të pikëzuar në mënyrë të ndryshme gjyqtarët bazuar në numrin e ditëve të kryera të trajnimit. Këshilli ka përcaktuar në Metodologji se të gjithë gjyqtarët që nuk plotësojnë ose tejkalojnë numrin minimal ose atë maksimal të ditëve të trajnimit të parashikuara në ligj do të pikëzohen me 4 pikë. Ky lloj pikëzimi i jep jo vetëm peshën e duhur trajnimit detyrues vazhdues për gjyqtarët, por i nxit ata t'i kushtojnë kohë vetë-përmirësimit në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinës. Në këtë mënyrë të gjithë gjyqtarët trajtohen dhe vlerësohen mbi të njëjat baza, sikundër është respektimi ose jo i numrit minimal të ditëve të trajnimit apo tejkalimi ose jo i numrit maksimal të ditëve të trajnimit.

Lidhur me shkaqe objektive të parashtruara nga gjyqtari në kundërshtimet e tij, Këshilli vlerëson se ato nuk ndikojnë dhe nuk merren parasysh në kuadër të vlerësimit etik-profesional, por vetëm në kuadër të procedimit disiplinor, pasi referuar nenit 102 pika 1 shkronja "h" të Ligjit "Për Statusin", mospërmbushja pa shkaqe të justifikuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në ligjin "Për Statusin", përbën shkelje disiplinore që lidhet me ushtrimin e funksionit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë vetëm në një aktivitet trajnues i cili ka zgjatur 1 ditë, gjatë gjithë periudhës 1/vjeçare të vlerësimit dhe për pasojë, vlerësohet me 4 pikë, pasi nuk rezulton të ketë marrë pjesë minimalisht për 5 ditë trajnimi, sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3, shkronja a)[79] të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

> ***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi****: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 4 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

---

[78] *Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë:*
a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;
b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.

[79] *Neni 5, pika 3, shkronja a) të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar , parashikon se « 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a)* ***jo më pak se pesë ditë të plota në vit*** *dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;…. »*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, gjyqtari {…} nuk ka marrë pjesë si ekspert/lehtësues në programe të trajnimit fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {…}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e tij në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në aktivitete të trajnimit vazhdues pranë SHM apo aktivitete të organizuara nga institucione/organizata të tjera, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna konkrete për pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Ndërkohë vetë gjyqtari ka shprehur dëshirën dhe vullnetin e tij për dhënien e kontributit në drejtim të përmirësimit të sistemit të drejtësisë.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtari parashtroi kundërshtimet e tij, duke u shprehur se: "*.....Pavarësisht angazhimit të lartë në përmbushjen e detyrave gjyqësore, me dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në fakt kam marrë pjesë në një veprimtari që mendoj se duhet të konsiderohet si ndërinstitucionale në kuptim të metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit. Konkretisht, në datën 20 tetor 2021, me ftesë të Misionit EURALIUS V, kam marrë pjesë në aktivitetin me temë 'Rritja e eficiencës në gjykatat e apelit', që është zhvilluar në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga Misioni EURALIUS V në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor ku të pranishëm kanë qenë anëtarë të Këshillit, përfaqësues nga misioni Euralius dhe disa gjyqtarë të gjykatave të apelit. Lidhur me këtë, bashkëlidhur paraqes ftetën e dërguar në rrugë elektrinike nëpërmjet emaili-t të datës 8 tetor 2021. Nën dritën e kësaj rrethane, mendoj se vlerësimi për nëntreguesin*

"Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata" duhet të jetë 5 pikë...".

Bashkë me kundërshtimet gjyqtari paraqiti në cilesinë e provës edhe komunikimin elektronik (email) nga rezultonte i ftuar në takimin me temën : " *Rritja e eficencës në gjykatat e apelit".*

Pasi dëgjoi relatoren e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarit e provën e paraqitur rishtazi prej tij, Këshilli vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatorit.

Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si (listë joshteruese) : fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efiçencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash te ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstitucionale, duhet të provohet kontributi dhe angazhimi efektiv i gjyqtarit për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Në këtë kuadër, vetëm pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetin e mësipërm, nuk përbën veprimtari ndërinstitucionale.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {…}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi*: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Ndërkohë, vetë gjyqtari në formularin e integruar të vlerësimit ka shpjeguar se nuk është angazhuar në këtë drejtim.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi**: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin "Publikimet ligjore akademike", gjyqtari pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit **KRITERI** **AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**	
Pikët	Niveli i vlerësimit
75	Shumë Mirë

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	75	Shumë Mirë
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	373	Shumë Mirë

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja "ç" të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {…} të plotësojë detyrimin ligjor për angazhimin e tij në procesin e trajnimit vazhdues dhe aktivitete të tjera për trajnimin e gjyqtarëve, në cilësinë e pjesëmarrësit apo lektorit,

pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {…}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2021 - 31 DHJETOR 2021

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				**Pikët total**	**Niveli i vlerësimit**
				100	**Shkëlqyeshëm**
Treguesit		**Burimet**	**Shkalla e aftësisë**	**Pikët**	**Të dhëna për metodologjinë**
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit**: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit**: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit**: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit**: E dobët – 2 pikë

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit**: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				**Pikët total** **98**	**Niveli i vlerësimit** **Shkëlqyeshëm**
Tregues		**Burimet**	**Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit**	**Pikët**	**Metodologjia**
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	**Jashtë afatit:** Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	**Jashtë afatit:** Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	**Koha mesatare**: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë

					Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	93-99%	8	**Tej standardit** : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	15	**Koha mesatare**: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të

					gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	**Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit**: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:** E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:** E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:** E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				**Pikët total**	**Niveli i vlerësimit**
				100	**Shkëlqyeshëm**

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	**Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:** E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	**Shkalla e integritetit të gjyqtarit** : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	**Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese**: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	**Numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit**: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				**Pikët total**	**Niveli i vlerësimit**
				75	**Shumë mirë**

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	**Qartësia dhe transparenca e komunikimit**: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	**Respektimi i konfidencialitetit:** I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	**Shkalla e komunikimit**: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	**Shkalla e komunikimit**: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit	<5 ditë (periudha 1/vjeçare)	4	**Pjesëmarrja e gjyqtarit**: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4 pikë

veprimtari të tjera		3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja			5-40 ditë (periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			**373**		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			**Shumë mirë**		